REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 pika h të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës_____2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01-462/01-2657 DATË 14.01.2025 PËR MIRATIMIN E OFERTËS NIKA PRO-ING SH.P.K TË PËRZGJEDHUR NGA KOMISONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

SHFUQIZOHET, Vendimi 01-462/01-2657 datë 14.01.2025 i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, për miratimin e ofertës "Nika Pro-Ing sh.p.k" të përzgjedhur nga Komisoni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve, duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit për shkëputje të kontratës të 1Nr.462/01-21616 të datës 05.10.2026.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

A r s y e t i m

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Ofertuesi "Nika Pro-ing SH.P.K", me numër unik identifikues 811052307 me adresë: Rr. "Rexhep Bislimi" pa numër Ferizaj, me pronar z.Shpend Musa, marrësi i pronës në shfrytëzim i cili është përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për marrjen e parcelës komunale P-71409059-00559-11 me sipërfaqe prej 10000m^2 në ZK-Babush i Muhaxherëve, në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, në emër të kompanisë "Nika Pro-ing SH.P.K", z.Shpend Musa, duke

bazuar në Vendimin paraprak 15N.463/06-22761 datë 08.05.2024 të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të komunës dhe miratimit të ofertës sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 01-462/01-2657 datë 14.01.2025 për përzgjedhjen nga ana e Komisionit Vlerësus për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, është lidhur Kontrata 1Nr.462/01-21616 datë 29.04.2025 në mes Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit z.Shpend Musa, pronar i biznesit "Nika Pro-ing sh.p.k", për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Duke u bazuar nga gjendja faktike në teren të realizuar me datë 08.09.2026 nga zyrtarët e Sektorit Pronësoro-Juridik dhe të Drejtoratit për Kadaster dhe Gjeodezisë, njoftimit nga Zyra e Kryetarit Sektori Pronësoro-Juridik nr 01-462/01-21616 të datës 18.09.2026, lidhur me realizimin e punimeve në teren nga subjekti përfitues që ju është dhënë prona në shfrytëzim afatgjatë, shfrytëzuesit Nika Pro-ing, nuk ka kthyer asnjë përgjigje me shkrimë lidhur me mospërmbushjen e obligimeve konform kontratës, njoftimi nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrotje të Mjedisit Nr.351/01-48656 datë 22.09.2026 nuk ka pranuar asnjë kërkesë lidhur me caktimin e kushteve ndërtimore apo lëshimin e lejës ndërtimore nga "Nika Pro-Ing" SH.P.K në cilësin e përfituesit të kontratës.

Raporti i komisionit për monitorimin e kontratave afatëgjatë 01-052/01-46018 i datës 03.09.2026 ka konstatuar se nuk ka filluar asnjë investim në teren nga "Nika Pro-Ing", ndërsa në Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadastër është azhuruar-regjistruar e drejta e shfrytëzimit me datë 22.04.2025 në parcelën katastrale P-71409059-00559-11 me sipërfaqe prej 10000m^2, në ZK-Babush i Muhaxherëve, po ashtu e ka kaluar afatin kohor i përmbushjes së obligimeve në bazë të kontratës.

Prandaj, bazuar në arsyet e theksuara më lartë dhe konform dispozitave ligjore në fuqi, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

Nr. 01-462/01-52693

Lipjan, më 19.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti